



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 57/2012
Prishtinë, më 11.04.2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha – Shala, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Ramiz Kelmendi, Berat Buzhala dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Ismet Shala, Dukagjin Shala dhe Arbnor Kastrati – MZHE; Shyqyri Hyseni - MF; Ahmet Tmava, Sali Mulaj dhe Xhevdet Kastrati - KPMM; Adil Januzi – KEK; Halil Çela – Trepça; Fatmir Asllani - Shoqata e Zhavorrit; Jenuz Bulica – kompania Sharrcem; Sannis Moutatis dhe Ekrem Tahiri - kompania e Ferronikel; Ukë Gashi-ZPRK dhe Elizabeta Gjiododa – KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 03.04.2012;
3. Seance dëgjimore lidhur me Listën e rentave minerare;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 03.04.2012

Procesverbali i mbledhjes së datës 03.04.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Seancë dëgjimore lidhur me Listën e rentave minerare

Kryetari – Theksoi se për këtë mbledhje kemi vendosur ta mbajmë këtë seance dëgjimore në përputhje me nenin 50, paragrafi 2, të Ligjit për miniera dhe minerale, në të cilin thuhet se: *Pas pranimi të Listës së propozuar, Kuvendi konsultohet dhe merr parasysh pikëpamjet e palëve të tjera të interesuara, duke përfshirë bartësit ekzistues të licencave ose përfaqësuesit e tyre, bën ndonjë ndryshim në Listë, që Kuvendi e sheh të domosdoshme ose të përshtatshme dhe e miraton atë Listë.* Kështu Komisioni sot u ka ofruar mundësinë të gjithë aktorëve, që shfrytëzojnë mineralet, si institucioneve, shoqatave dhe kompanive, që ta japin kontributin e tyre.

Të ftuarit, si: **Ismet Shala** dhe **Dukagjin Shala** - MZHE; **Shyqyri Hyseni** - MF; **Ahmet Tmava** - KPMM; **Adil Januzi** - KEK; **Halil Çela** - Trepça; **Fatmir Asllani** - Shoqata e Zhavorrit; **Jenuz Bulica** - kompania Sharrcem; **Jannis Moutatis** - kompania e Ferronikel dhanë opinionet e tyre për Listën e rentave minerare të propozuar nga Qeveria.

Deputetët **Lutfi Zharku**, **Hashim Deshishku**, **Sala Berisha** – **Shala**, **Teuta Sahatqija** dhe **Myzejene Selmani** diskutuan dhe shtruan pyetje për të ftuarit.

Pas debatit të gjerë, Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Komisioni do të vazhdojë me shqyrtimin e Listës së rentave minerare pas pranimi të propozimeve nga institucionet përkatëse dhe nga palët e pranishme në këtë mbledhje.

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Këtij procesverbali i bashkëngjitet transkripti i seancës dëgjimore.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI,
TË MBAJTUR MË 11.04. 2012

PRILL
2012

E mërkurë, më 11. 04. 2012

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Zenun Pajaziti,

KRYETARI: Mund të fillojmë, faleminderit shumë për pjesëmarrjen!

Ju falënderoj të gjithëve kolegë deputetë dhe gjithë ju përfaqësues të institucioneve përkatëse dhe të kompanive. Sot e kemi paraparë në mbledhjen e radhës të rregullt të Komisionit edhe një seancë dëgjimore lidhur me listën e rentave minerare.

Dëshiroj para se të fillojmë me pikën formalisht, me qenë se ne jemi pajtuar në mbledhjen e kaluar të komisionit çka kem në këtë rend të ditës, por formalisht kërkoj një aprovim për rendin e ditës. Faleminderit! Po ashtu edhe për procesverbalin e datës 3, nëse ka dikush diçka, nëse jo kërkoj po ashtu një aprovim, është “për”. Faleminderit!

Ne na ka ardhur, ka para dy jave lista për rentat minerare nga Qeveria. kemi vendos në komision që ta kem edhe një seancë dëgjimore. Konsiderojmë ne edhe në përputhje me ligjin, është në nenin 50 të Ligjit për miniera dhe minerale, është një paragraf që thotë: “pas pranimi të listës së propozuar Kuvendi konsultohet dhe merr pikëpamjet e palëve tjera të interesuara duke përfshirë bartësit ekzistues të licencave ose përfaqësuesit e tyre, bënë ndonjë ndryshim në listë që Kuvendi të shoh të domosdoshme apo të përshtatshme dhe e aprovon atë listë”. Pra, para se ta dërgojmë ne në seancë si Komision, kemi vendos që ta kem edhe këtë seancë dëgjimore me ju në mënyrë që Komisioni pastaj eventualisht nëse do të ketë ndonjë propozim ose ndonjë çështje për ta trajtuar në lidhje me këtë listë ta përcjellë në seancën e Kuvendit për miratim.

Rregulli në seanca dëgjimore është i tillë që ne kemi pas edhe raste të tjera, ne kryesisht ju dëgjojmë ju e pastaj deputetët nëse kanë ndonjë pyetje mund të ju drejtohen juve veç e veç deputetët, anëtarët e komisionit mund të ju drejtohen ju edhe në ndërkohë që ju bëni prezantimin tuaj secili prej jush. Pra, në çfarëdo kohe në çfarëdo .. si deputetë kërkojmë fjalën kanë ndonjë pyetje mund ta bëjnë cilindo prej rasteve.

Fillimisht kisha kërkuar që fjalën ta merr përfaqësuesi i Ministrisë së Zhvillimit, Ekonomik, si një prej ministrisë. Besoj që do të jenë të dakorduar edhe me Ministrinë e Financave, do t’i japë fjalën edhe Ministrisë së Financave, pastaj Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. E keni fjalën zotëri e bëni prezantimin.

ISMET SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Përhëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë jam Ismet Shala, jam drejtor i Departamentit të Minierave. Bazuar në Ligjin për minierat dhe mineralet, neni 2, paragrafi 2, resurset minerale pavarësisht nga prejardhja e tyre, forma ose gjendja fizike që gjindet në brendësi të tokës apo në sipërfaqe të saj janë pronë e Republikës së Kosovës.

Pas që pasuria minerare është pronë e shtetit, të gjitha kompanitë që merren me shfrytëzimin e resurseve minerale janë të detyruar që të paguajnë një lloj takse renë minerale, do të thotë kjo renë paguhet për vendburimet minerale që janë të parapërtitshme do të thotë merren një herë edhe shteren.

Sipas Ligjit për miniera dhe minerale Ministria e Zhvillimit Ekonomikë dhe Ministria e Financave pas konsultimit të Komisionit për Miniera dhe Minerale dhe pikëpamje që merren nga licencuesit në ndërmarrje e harton një listën për rentë minerale të cilën edhe e dërgon në Qeveri. Mbështetur në këtë Ministri të Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Financave konsultim me KPMM-në dhe palët e tjera të interesuara e ka përgatit listën dhe e ka dërguar në Qeveri.

Lista përmban grupin e lëndëve minerale, do të thotë mineralet energjetike, metale, industriale, ndërtimore, gurët e çmuara dhe gjysmë të çmuar dhe ujin mineral dheGrupet e lëndës minerale janë ndarë në grupe dhe janë specifikuar në lëndë minerale.

Te mineralet energjetike konkretisht te qymyri renta minerare llogaritet në tonë dhe është propozuar të jetë fikse 3 euro. arsyeja pse është të jetë fikse 3 euro, është për arsye që investitori i ardhshëm që investon termocentralin e ri ta shtyjë investitorin rreth teknologjive të reja më të avancuara. Kjo është arsyeja që ne si ministri e kemi propozuar që të jetë 3 euro. Renta minerale, te mineralet metale propozohet të jetë 4.5 deri në 5%, 5% zakonisht është propozuar të jetë te mineralet e arit dhe platinës. 5% e vlerës sipas LMES, sipas bursës së Londrës. Kjo është marrë. Kurse për mineralet industriale parashihet të sillet nga 2 deri 4%. Në raste të veçanta siç janë argjila dhe disa minerale kimike teknike dhe minerale zjarrruduese janë marrë çmimet fikse bazuar në shtetet e rajonit.

Për sa i përket mineraleve ndërtimore në listën e propozuar është bërë ndarja në resurse që e shfrytëzojnë me menim dhe pa menim. Për kategorinë çmimi i rentës minerare është fiks dhe sillet me minim 0.5 deri 0.6 euro në metër kub kurse pa minim 0.6 deri 1 euro për metër kub. Për gurë gjysmë të çmuar dhe gurë dekorativ propozohet që renta minerare të sillet nga 3.2 deri në 4.0%.

Kjo ishte sa i përket listës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë zoti Shala!

E doni fjalën Ministria e Financave.

SHYQYRI HYSENI: Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Shkurtimisht duhet të jem i qartë, përndryshe jam Shyqëri Hyseni, drejtor i administratës, vijë këtu si i deleguar i sekretarit të përgjithshëm i cili sot nuk ka ardhur në punë.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave kanë marrë pjesë aktiv në grupin punues dhe i kanë sjellë të gjitha ato mundësi edhe propozimet e veta, kështu që është një pajtim i grupit punues që ka punua rreth kësaj liste që ka shkua në Qeveri dhe është aprovua.

Vetëm dua të ju njoftoj se këto të hyra nuk janë të dedikuara por janë të hyra që i takojnë Buxhetit të Republikës së Kosovës të hyrat e përgjithshme. Në qoftë se ka diçka Komisioni në lidhje prej Ministrisë së Financave ne jemi të gatshëm për bashkëpunim dhe për të vepruar diçka. Përndryshe faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë! Zoti Tmava,

AHMET TMAVA (KPM): Të nderuar deputetë. Ju si deputetë jeni për një përgjegjësi me të vërtetë që kërkon me vëmendje, nuk dua tash të ju sugjeroj se ju e dini më mirë se unë por megjithatë kemi të bëjmë me një lëmi që është shumë e ndjeshme. Ideja është që buxhet për Kosovën, mirëpo ideja është edhe që t'i distibulojmë bizneset.

Unë veç po dua me bë edhe një sqarim. Sa i përket rendës minerare të propozuar për qymyr nuk është fikse, në realitet është fikse por kemi kërkuar ne si institucion që jemi përfaqësues edhe në Projektin Kosova e Re, që kjo të zërthehet dhe të jetë e kuart, 3 euro reflektuesi 5% e vlerës së valorizuar. Domethënë vlera e valorizuar të resursit 5% dhe 5% i vlerës së valorizime ka reflektua 3 euro. Pse po them, ne kemi kërkuar si deputetë duhet ta keni këtë informatë sepse po e bëni një aprovim me që reflekton me interes. Në mënyrë që të mos thuhet se është bërë ndonjë kalkulim i pabazuar por është i bazuar fiks qymyri kur ka reflektua në produktin final, vlera e valorizuar është 60 euro, 5% në 60 euro është 3 euro, dhe kjo detyrë, pse detyrë që mbrohet

interesi i vendit por mbrohet edhe biznesi, pse, nëse qymyri domethënë resursi reflekton një produkt të cilit i rritet vlëra në treg dhe shtetit do t'i rritet interesi por edhe anasjelltas, nëse bjenë domethënë që mos e kërcënojmë biznesin bie edhe vlëra, domethënë veç të kemi të kuart. Të gjitha përqindjet që reflektojnë nuk janë vlëra fikse por janë vlëra të cilat përcaktohen sipas periudhave kohore që i përcakton Berza ndërkombëtare.

Ne si institucion merremi me mbledhjen e rentës minerale, nuk është kompetencë e jona me përcaktua rentën minerare, mirëpo këtu është e mira e kësaj se për herë të parë renta minerare në mënyrë publike po trajtohet dhe po aprovohet në institucionin më të lartë të vendit. Prandaj, këtu është një e mirë që për herë të parë që po ndodh edhe kjo e kërkon një qasje shumë serioze në mënyrë .. të reflektojnë interesat e përgjithshme. Çdo gjë që reflekton në përqindje po them ndryshon kohë. Ju e përcaktoni si politikë që në kuadër të sugjerimeve në aspektin zhvillimorë të jetë joshëse për investitorë por edhe të rruhet interesi i vendit. Por ne në kuadër të kësaj ne kemi pasur edhe përfaqësuesin në Komision dhe unë mendoj që kemi dhënë kontributin që na ka takua dhe përsëri do të japim.

Megjithatë në kuadër të kompleksitetit ne përsëri do të ngarkohemi sepse ne mendojmë që nuk u krye puna me që kjo listë e propozuar në këtë formë të shkon tek deputetët sepse edhe deputetët janë të lamive profesionale, por të ju japim materiale sa më të përpunuara, të specifikuara në mënyrë që të dihet se çka po aprovohet. Ne si KPMM kemi sugjerua procedurat qysh llogariten dhe me mënyrën e procedurave qysh llogariten renta minerare përsëri do të ju njoftoj juve si komisionin më profesional i thirrur në mënyrë që të ketë të kuart ta zë. Ne kemi përpunuar 2 – 3 alternativa qysh llogaritet, resursi mineral është kategori kushtetuese okej, nëse është kategori kushtetuese dhe mbetet resursi mineral në gjendje natyrore a do të llogaritet tani me lagështi apo pa lagështi, deri tash ka pasur laramani dhe kjo tash duhet të bëhet më shumë transparent para juve që ju ta keni të kuart çka po aprovoni dhe nëse përdoremi një udhëzim administrativ aprovuar nga ju do të zyrtarizohet që të mos ketë as më të voglën paragjykim ose përfolje. Ose kemi edhe në kuadër të listës së përcaktimit të rentës minerare, janë disa renta shumë të ulëta në aspektin e politikave zhvillimore të vendit që të shfrytëzohen resurset tana të mos na vije materiale të ndryshme sidomos për ndërtim nga jashtë, por janë edhe disa të cilat si resurse që i kemi, kemi tentua me reflektua interes sa më shumë për vendin.

Mbi procedurat edhe një herë po them ne ngarkohemi si KPMM që udhëzimin administrativ ta përpunojmë. Ne kemi dhënë edhe sugjerime që përsëri kërkojmë ndihmën tuaj sepse është shumë me interes, se ta zëmë. Në kuadër të përcaktimit të rentës minerare ka edhe politika stimuluese. E cila është politika stimuluese? Një resurs mineral nëse e rritë shkallën e finalizimit të resursit, a duhet t'i zbritet renta apo në aspektin e stimulimit, të bëhet më bukfal. Nëse Trepça nuk shtet koncentrat apo shtet metal të pastër për një shkallë të finalizimit ja zbrisim rentën minerare sepse e joshin biznesin që ta rritë shkallën e finalizimit, ose çfarëdo qoftë resursi mineral nëse e risim, mirëpo edhe kjo kërkon precizitet. Kërkon precizitet dhe po them duke u thirrur në lëmin profesional. Ne do të japim sugjerime por gjithsesi po kërkojmë që të jemi transparent dhe të japim mundësinë që i tërë komuniteti edhe i biznesit edhe shoqëria civile edhe gjithkush të japë kontributin, sepse përcaktimi i shkallave të finalizimit kërkon një precizitet a është një hapë teknologjikë, po e quaj tash një hapë teknologjikë, niveli i minierës së Feronikut me shkritore, analog në një hapë ta zëmë te flutimet në..., nëse po me çfarë shkalle stimuluese duhet ta stimulojmë një biznes të tillë.

Prandaj, unë i hapa jo rastësisht këto tema sepse dua të bëhemi korrektë para jush dhe para opinionit të gjerë në mënyrë që aprovimin e rentës minerale ta merr peshën e vetë, ne mendojmë që është në peshë, nuk është kompetencë e jona sepse këtë e ka procedua Ministria e Financave me Ministrinë e Zhvillimit kurse në aspektin e ligjit ne kemi një rolë sugjerues që unë mendoj që si institucion e kemi luajtur rolin dhe tek e fundit ne jemi institucion që ju japim llogari juve

drejtpërsëdrejti edhe për këtë shkak desha të jem i hapur drejtpërsëdrejti. Prandaj, unë jam këtu, kam edhe kolegë që janë marr zoti Sali Mulaj, që ka qenë drejtpërsëdrejti i kyçur, është edhe një anëtar i bordit që, por edhe me tërë potencialin që ka për KPMM jemi në disponimin tuaj që të ju japim informacione dhe aprovimin që do ta bëni ju të jetë plotësisht i bazuar në bazë të sugjerimeve dhe korrektësisë që ju e pretendoni tek e fundit si institucioni më i thirrur. Po e them edhe një herë për nivelin e kësaj liste që është përcaktua kjo është e diskutueshme për ju dhe a do ta stimulojmë me këtë listë, me i zvogëluar, me i rritë, mirëpo është një propozim që unë mendoj që i ofrohet realitetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Tmava edhe për sqarimet shtesë. Kishim vazhduar me radhë, janë tash përfaqësues të disa kompanive, është përfaqësuesi i KEK-ut, zoti Jonuzi, e keni fjalën, nëse doni me marrë.

ADIL JONUZI (KEK): Faleminderit, zoti kryetar! Përhëndetje të pranishmit. Unë mendoj se renta është llogaritur, nëse është llogaritur variabile është shumë mirë për arsye se, sigurisht është llogaritë para dy viteve ku megavati ka qenë 60 euro, kurse sot një megavat është 80 euro.

Unë mendoj se kjo rentë është bazuar që në termocentralin e ri i cili termocentral në të ardhmen shihet që të harxhoj ose për prodhimin e një megavati do të shpenzoj një tonë qymyr. Kurse ne kemi te termocentralet ekzistuese, e kemi një harxhim tjetër ose një ...specifik tjetër i cili te Termocentrali A është 1.9 tona për një megavat kurse te Termocentrali B është 1. 5 tona për megavat. Çka do të doja të theksoja këtu është se nëse propozohet atëherë ju e dini se te vendosja për privatizimin e KEK-ut parasheh që Termocentrali A në të ardhmen do të mbetet pronë e Qeverisë e ajo do të ketë, sigurisht do të ketë një shpenzim i cili do ta ketë dyfishin ose mujë me thanë që Termocentrali A për prodhimin e një megavati ose për prodhimin final për duke do ta ketë një trrërë rentën, kurse Termocentrali Kosova A, do ta ketë një 6 euro, kështu që këtu duhet të kem kujdes në të ardhmen për Termocentralin A i cili do të jetë pronë e qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë zoti Jonuzi!

JANNIS MOUTAJIS (Ferronikeli): (Marrë nga përkthimi simultan)

Përhëndetje, unë quhem Jannis Moutajis, jam drejtori gjeneral i ri në Feronikël. Në këtë pozitë jam veç që një javë ditë, punoj që 5 vjet në Kosovë, kam mjaftë njohuri për çështjet që po diskutojmë. Ju falënderoj për ftesën! Sepse çështja e rentës minerare është çështje mjaftë me rëndësi për lëmi.

Kisha dashtë me fillua për pak më herët se si ka qenë. Në kohën e privatizimit renta minerare për një .. ka qenë rreth 1.5%, Në këtë kohë kjo është pa se... mjaftë i arsyeshëm edhe me shkrimet e rentave minerare për nikël në shtetet tjera në Ballkan, siç ndoshta disa prej juve e dini ne kemi një kompani tjetër në Maqedoni, është një ... mjaftë e ngjashme dhe renta minerare për nikël në Maqedoni është 1.5%, kurse në Greqi nga përvoja ime e më hershme është 1%. Në vitin 2010 renta minerare është ngritë për nikel në 4.5%, kjo na ka vendos në një situatë mjaftë të vështirë. Ka pasur një ndikim mjaft të madh në koston tonë. Në atë kohë i kemi pasur dy miniera operative në Kosovë, një në Çikatovë e një Gllavicë, 60.000 xehe lokale në muaj. Gjithashtu, në atë kohë i kemi kontraktuar edhe tri kompani vendore, me rreth 60 të punësuar.

Pas kësaj ngritjeje, ne kemi parë që është më profitabile për neve, më benifituse me e importua xehen se sa me e nxjerrë. Ngadalë, ngadalë kemi ardhur në një situatë ku rreth 70 deri 75% e xehes që ne e përdorim, e marrim nga jashtë, e importojmë nga lindja e largët, nga Shqipëria, kështu që përdorimi i xehes vendore për momentin për nevojat tona, është sillët në nivel rreth 20 tonë, 20.000 tonë në muaj.

Fatkeqësisht kemi ardhur një situatë që neve na duhet me importuar xehe nga ana tjetër e botës, nëse mundem me thënë edhe pse me një benificion pak më të mirë për xehen vendore, do të ishte shumë më e dobishme për neve, siç kam dëgjuar nga ata që folën më herët. ROALTIT munden me i stimuluar investimet e huaja dhe munden me shërbyer si lloj motivi për investitorë të huaj për shfrytëzimin e resurseve natyrale në Kosovë.

Nuk (Unë) kisha dëshiruar me kërkuar prej jush nëse është e mundur në lidhje me uzinat vendore nacionale që me shikuar mundësinë që, në njëfarë mënyre të zvogëlohen renta minerale. Jam mjaft optimist për të ardhmen. Pres që çmimi i nikelit në breza ndërkombëtare të ngritët sepse për momentin është në nivel shumë të ultë. Jam kofident që me një vlerë më të vogël të rentës minerare, do të kemi mundësi të prodhojmë prapë me të dy minierat tona dhe gradualisht të rrisim përdorimin e xehes vendore, sepse është mjaft keq që edhe për komunitetin vendor edhe për neve si kompani por edhe për interesat e shtetit. Që ta kemi këtë të mirë materiale nga Zoti nga natyre këto resurse minerare, mirëpo të mos rrisim ose maksimizojmë përdorimin e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Të japim fjalën të gjithë përfaqësuesve, pastaj zotit Tmava.

HALIL QELA (Trepça): I nderuari kryetar, Pajaziti! Të nderuar deputetë, Të nderuar përfaqësues të Qeverisë së Republikës, Të nderuar përfaqësues të institucioneve, Kompanive vendore, Ju përshëndes! Ju faleminderit për ftesën.

Unë kujtoj që kjo është një prej temave më të rëndësishme sa i përket çështjes së ekonomisë që është bazament për të ardhmen. Më vjen keq që, ndoshta në disa pika kisha mu duktë sikur po e kam mendimin e njëjtë me përfaqësuesit e Feroniklit për shkak se unë mendoj se ose renta minerare 4.5% për mineralet e plumb-zinkut, mendoj se është e lartë. E jap vetëm një llogari që e kam bërë sot, do me thënë për 39.000 tonë që i kemi prodhuar na, për shembull në 3 mujorin e parë, duhet me 209.672 euro.

Unë mendoj se më mirë është përmes institucioneve relevante me e kontrolluar sasinë e prodhimit që të deklarohet reale e ajo të bëhet me një vlerë më të vogël, për shembull: po e zëmë në Mal të Zi ... në një minierë që Trepça e ka qelë, e ka 2.5% është po ashtu minierë e plumb zinkut edhe po është kujdesie edhe në sasinë e prodhuar të xehes se aty të mos bëhet ndonjë, mos ta përdori fjalën falsifikim ose ndonjë fshehje e sasisë të prodhimit. Kështu që, unë veç desha me thënë se ndoshta është mirë me e diskutuar por unë mendoj që edhe Komisioni i pavarur për miniera e minerare shumë e ka shqyrtuar këtë çështje. Por, mendoj se ndoshta kur të vjen si miratim përfundimtar në Parlamentin e Kosovës, me menduar se cila është më e mirë. A më e mirë 4.5% e ndoshta dikush me i ikë sasisë të deklaruar apo, nuk e di. Ju faleminderit!

KRYETARI: Përfaqësuesi i Sharcemit

JENUZ BULICA (përfaqësues i Sharcemit) Të faleminderit, zoti kryetar! Të nderuar atë pranishëm. Është një rast i mirë që na keni ftuar me biseduar për ... për shkak se për biznesin janë mjaft të rëndësishme. Edhe ne mendojmë se... është pak e lartë kur dihet se tani edhe konkurrenca në treg është shumë e madhe Këtu e kam një vërejtje tenë mineralet ndërtimore, kurse mineralet ndërtimore janë dhënë në tri nëngrupe: me nim, pa minim dhe materiale të palidhura....

Unë mendoj se këtu është bërë një gabim kur është shkruar me ... për çimento dhe e kanë futur në materialet e palidhura... për shkak se, nuk besoj se në Kosovë ka diku materiale pa... që prodhohet çimento, kështu që na mendojmë se duhet të bimë në grupin e mineraleve ndërtimore pa minim. Jo, nuk munden me qenë se, nëse hynë, nëse hynë në grupin e mineraleve pa minim,

atëherë janë llogaritur... me siguri kur e kanë minuar këtë punë me e caktuar RENTEN, e kanë mendar edhe puna që duhet të kryhet për me e marrë atë material, kështu që në materialet e palidhura, është një punë që kushton shumë më lirë se sa në materialet e grupit tjetër. Kjo ishte vërejtja ime.

KRYETARI: Ju faleminderit!

FATMIR ASLLANI: kryetar i Shoqatës “Zhavorri”

Unë mendoj që krahas stimulim bizneseve dhe shfrytëzimit të resurseve natyrore që i ka dhënë Zoti, na duhet të mendojmë pak edhe për ambientin. Të gjitha veprimtaritë tona, kanë të bëjnë me një veprimtari bajagi të ndjeshme dhe të rëndë. Dihet se duhet me shkatërruar diçka për me nxjerrë atë mineral, kështu që na prej Shoqatës “Zhavorri” dhe na e kemi një kërkesë lidhur me taksën e rentës minerare ku kemi të bëmë me rehabilitimin e ... pasi që të shfrytëzohet kostoja, por po lypet.....do me thënë kostoja dhe një pjesë e konsiderueshme e këtyre pronave janë shfrytëzuar dhe janë mbetur pa u rikultivuar për shkak, po mendojmë që 1 euro e 25 cent i kemi për metër kub, me mujt me e ndarë 50% , 50 tjetër me ia dedikuar rikultivimit të atyre parcelave të cilat janë duke u shfrytëzuar. Nuk di sa jam... kësaj takse me e ndarë këtë shumë 50% me ia dedikuar rikultivimit atë 50%-ish, po 50% të kësaj me e nda edhe me ia dedikuar rikultivimit më shumë, kemi nevojë me i rikultivuar ato pjesë të cilat janë duke u shfrytëzuar. Kaq kisha.

KRYETARI: Ju faleminderit! Më erdhi mirë që ju të Shoqatës “Zhavorri”(nuk dëgjohet për transkriptim)

FATMIR ASLLANI, përfaqësues i Shoqatës “Zhavorri”: Është hera e parë që marrë pjesë në takime të këtij lloji edhe pse.... Javën e kaluar na ke kemi marrë një, e kemi nënshkruar një memorandum me Ministrinë e Ambientit edhe me Komisionin e pavarur të Minierave, kompani të cilat janë të licencuara për me pasur të drejtën me e shfrytëzuar atotë cilat janë të licencuara.

KRYETARI: Ju faleminderit! Ia kisha dhënë fjalën zotit Tmava.

AHMET TMAVA: ... institucion, ju jap edhe juve ju llogaritë që çdo informatë që ne e disponojmë, ta keni edhe ju si deputetë të nderuar. Zotëriu nga Feronikli, informatën që e dha, e dha vetëm nga këndvështrimi i biznesit të tij qysh i dhanë edhe të tjerët, mirë por nuk ishte complete, nuk ishte complete sepse edhe për “Sharcem”-in, edhe Feronikelin edhe për çdo kompani tjetër, do ta keni materialin e përpunuar.

Zotëriu, jo rastësisht unë fillim thash që në kuadër të TANTIEMËS, zotëri që ka zbrit vlera 40% e lagështisë që për e diskutueshme, sepse resurset në gjendje natyrore, nuk e përmendi zotëriu. Zotëriu nuk e përmendi edhe stimulimin që e ka bërë Qeveria kur ia ka zbritur tantiemën, kur ka zbritur niveli. Jo rastësisht në fillim thash, që tantiema do të përcaktohet në mënyrë empirike, në mënyrë, në një formulë nuk do të bënte Pazar i vagës, por do të jetë, e llogaritëm në mënyrë shkencore dhe mbi procedurën e llogaritjes që ne do të jemi në kontakt drejtpërdrejtë me Ministrinë e Financave, do ta keni, do të jetë transparent dhe do ta aprovoni. Nuk e përmendi, por ju ka habitur tantiema në 2%,nuk e përmendi lagështinë që për mua është në për respektin profesional është e diskutueshme se a është ajo lagështia, a nuk është ajo lagështi. Tek e fundit, çdo resurs natyror që ndodhet, çdo resurs ka lagështi. Pse për dike llogaritet e për dike jo. Edhe sa i përket KEK-ut, edhe sa i përket Sharcemit edhe çdo kompanie tjetër.

Na e dimë Trepça dhe KEK-u, qysh janë duke vepruar, nuk janë këto kalkulime për nivelin e sotëm sepse sot bëhet një mbijetesë e jashtëzakonshme për me e ruajtur minierën e Trepçës për me e qitur në prodhim, në prodhimin e mirëfilltë a do të bëhet nëpërmjet sektorit privat apo publik, kjo është e juaja të vendosni. Mirëpo, nuk ka qenë ideja e ngarkesës deri me tani, por për vizione nëse shkohet në procesin e privatizimit. Nuk është te tantiema 6 euro për A-në ose për B-në, por pikërisht sepse edhe këtu ka pasur keqinterpretime mbi reflektimin se 3 euro do të reflekton në ngritjen e energjisë elektrike, absolut jo, sipas neve. Pse jo? Sepse sasia e qymyrit që e prodhon “Kosova A”, sot një njësi e prodhimit të energjisë dhe “Kosova e Re” nuk do të jenë të njëjta, por ne kemi llogaritur për parametrat që nesër do të hyjnë, por tek e fundit një milionë argumente ekzistojnë në procesin zinxhiror të prodhimit se ku mundet me u kursyer 3 euro sepse është marr nga profiti se a është 5% a është 0,5%, ju vendosni se unë për këtë nuk këmbëngul, por ekziston mundësia e punës racionale, e efektivitetit dhe po flasim për vizion,sepse deri tash KEK-u e ka pas 23 cent, 26 cent. Do me thënë, absolut kemi qenë shumë afër. Po edhe me Trepçën, na i dimë angazhimet e jashtëzakonshme që është ruajtur miniera që dy vite, është në ... të resursit. Por, nëse shkohet në një dinamik të prodhimit, qoftë e edhe me ndonjë komitent privat, them që nuk është e imja tash me fol, përsëri do të dihet interesi i vendit, por përsëri ju do të jeni ata që i përcakton. Mirëpo, mënyra e llogaritjes do të jetë fiks, gjithçka e precizuar, prej xehes së Trepçës nxirret plumbi, zingu, agi e argjendi, 4 komponente, edhe jo rastësisht 5 procese teknologjike. Pse procesi teknologji, hapi i parë i shkrites, Feronikli nuk u bë korrekt kur tha edhe që merr xehe prej jashtë, nuk e merr xehen prej jashtë për mihjen e ... minerale. Por, tek e fundit nëse e mendon këtë logjikë se këtu në aspektin ambientet, koka anarki, kjo nuk është kompetencë e imja, është e juaja.

Xehen prej jashtë e merr për me e ngritë, për me e rritë cilësinë. Xehen që e merr nga jashtë, e merr për me e ngritur cilësinë, e në aspektin e procedurave teknologjike të përpunimit. Të paktën kështu na kanë thënë dhe kështu janë argumentet. Për me mundur me nxjerrë me 0.8. 0.9 deri 1% të xehes që e kemi në ... Kosovë, e merr me 1.2 a me 2%, nuk e di sa mirëpo e merr që të krijoj në produkt për proces teknologjik . Të gjitha këto janë procese, po e them edhe një herë që ne,në mënyrë të përpunuar, në mënyrë të shkruar, në mënyrë të diskutueshme, të nderuar deputetë, do t’ua dorëzojmë juve,kurse ju jeni ata që e perceptoni. Sot nuk i kam marrë, mirëpo në një takim, do t’i sjellim të gjitha edhe të regjionit, por edhe më larg, realisht ka tantiema edhe më të vogla... Mirëpo, edhe listat se qysh përcaktohet tantiema qysh është në vendet tjera, do t’i përcjellim, sepse tek e fundit këto janë publike, nuk kemi nevojë do me thënë askush me na treguar. Ne do t’i marrim dhe do t’i prezantojmë para jush që t’i keni element krahasues. Mirëpo, ndoshta nuk është momenti këtu me i hapë këto letra.

DUKAGJIN SHALA (MZHE): Renta minerale prej vitit të kaluar, në Serbi është ngritur. Faktikisht e ka pasur një rentë më to vogël, tash është për resurset metalore 5%, do me thënë është më e lartë se te na. Në Maqedoni është fakt që është më e ultë, por edhe në Kosovë, para vitit 2010, ka qenë 1.5, jo asnjëherë nuk ka qenë ndër 2%. Edhe me listën e parë ka qenë 2% që është bërë menjëherë pas lufte. Tash, në vitin 2010,është ngritur 4.5%. Tjetër, na e cekëm atë se e kemi një udhëzim administrativ për llogaritjen e rentës,aty parashihen edhe lehtësimet në qoftë se ajo xehe që nxirret në Kosovë përpunohet edhe shkon në përpunim final, ka zbritje. Te pasurimi për shembull është 10% , te nxjerrja e metalit të pastër që është Feronikli, është 20% zbritje i tantimës, do me thënë asaj vlerës prej 4.5% - 20% ka zbritje, ashtu është e papara edhe këtu veç kaq pata.

KRYETARI: Faleminderit, shumë...! Prej deputetëve dikush nëse ka pyetje, nëse ka interesim? Zoti Zharku!

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar! Përshëndetje gjithë të pranishmëve. Nëse ka mundësi ose prej Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik apo prej Komisionit të Pavarur, cilat janë rastet

konkrete në të cilat po i marrim është zvogëluar renta minerare me qëllim të nxitjes biznesit dhe cilat është rrit me qëllim të ngadalësimit apo zhvillimit të asaj veprimtarie? Kurrëgjë tjetër. Faleminderit!

(nuk dëgjohet për transkriptim)

ISMET SHALA (MZHE): ... e përcakton Ministria e Financave dhe Ministria për Zhvillim. Ne e luajmë rolin konsultativ, por deri tash ka qenë barrë që e kemi trashëguar por jemi në rrjedha po tentojmë me kontribui. Kështu që në vazhden e kësaj unë mendoj që rentat janë qashtu qysh kanë qenë të propozuara me naj ndryshim shumë të vogël, mirëpo... *(ndërpritet incizimi)* Po, në pjesën dërrmuese na e kemi pa që rentat minerare janë deri në 5% edhe për 0.5% i kemi ul. Sa i përket Ferronikelit ne kemi hasje në rentat nga 7.5 deri në 15%. Të parën herë e kemi propozuar 7.5% që s'ka kaluar, dhe u kthi sikur të gjitha mineralet tjera në 4.5%.

AHMET TMAVA (KPM): Ne po flasim për rastet konkrete, nëse është 5% po e marrim çimenton. Çimento sot është çmimi 80 euro, 5x5% në 80 euro është 4 euro, nëse po flasim 5% të vlerës ose në anën tjetër po e marrim zhavorrin që shitet në tregun e lirë 18-20 euro po e marrë, nëse është 5% i bie 1 euro a e kemi 1.25 euro. E po du me dit cilat janë mineralet, të cilat i kemi përkrahë, e kemi zbrit rentën nëse ju e keni atë analizë normal, nëse jo... nëse është ajo analizë, cilat janë ato minerale të cilat duhet me u përkrahë. Profesori e përmendi shumë mirë rastin e ndërtimitarisë e veprimtarive tjera, të cilat duhet me pas më të ulët në mënyrë që të përkrahet prodhimtaria dhe rritja e prodhimit e produktit etj. dhe në anën tjetër kemi veprimtari pa, nuk po e përmendi me emrin ... që kanë një situatë monopolistike që nuk kemi nevojë për më tepër Qeveria. A keni njëfarë analize, a mundemi me ditë konkret... po them dy raste është: çimento që kish mujt në qat aspekt 5% e rrok mbi 3 euro edhe e dyta e kemi zhavorrin që i bie shumë më pak se 1 euro se unë e mora çmimin që është 20 euro a parimisht me 12-13 euro ki që shitet.

Te zhavorri kem shku te rëra e zhavorrit kemi shku me qëllim... rent minerare më të lartë që me politikën që të mos zhvillohet, faktikisht ta ndalojmë e me politika zhvillimore. Ndërsa, te ... kem shku me çmim real që të shkon në zhvillim. Domethënë, qëllimi kryesor ka qenë parandalimi i zhvillimit të shfrytëzimit të rërës së zhavorrit nga lumenjtë dhe rreth lumenjve që ajo e ka bazën, faktikisht. Edhe aty kem shku, kem shku me qëllim...

(Ndërrhyrje: ...)

Qysh po mendon s'është?! Pse Ferronikeli është resurs metalor. Kem shku...

(Ndërrhyrje: Mineralet që shfrytëzojnë ...)

(Ndërrhyrje: ...)

Po, po flas në parim unë a bën me dit cilat janë arsyet? Po e marrim Ferronikeli e ka 4.5% apo 5%, Sharri e ka 1% po e marr 1.5%. Cilat janë parimet? Unë po flas për parimet cilat janë që është ... kjo apo kjo. Nëse flasim për një zhvillim të një industrie. Veç për kuptim timin, unë... Kërkesa e deputetit është shumë decisive dhe me të vërtetë kjo duhet të të jap sqarime në decidiv. Të bëhemi real të paktën unë sa kam informacione në grupet punuese nuk është përdorur parimi i përqindjes, sepse tek e fundi edhe 1 euro për zhavorr mundet me u zbërthi në përqindje. Zotëria po don me ditë domethënë sa e reflekton ai? Sado që këtu kemi të bëjmë 2 kategoritë: kategoritë me çmime fikse dhe kategoritë me përqindje që varen, domethënë nga berza dhe këtu ndryshojnë në kohë varësisht nga çmimi i berzës.

Mirëpo, gjithçka mundet me u zbërthyer në mënyrë që mu pa, domethënë parimi e tani le të shqyrtohet me elementet shitesë që thotë edhe profesori Dukagjin që të tregohet edhe në aspektin e politikave ... përdorë ajo. Mirëpo, edhe një përqeshje, sepse ... unë nuk dashta me hy në specifikim të secilës. Në aspektin e formimit të ... mërgeseve kjo do të jetë precize. Mergelët, të cilat përdoren për çimento do të kanë një rentë minerare, mirëpo kemi edhe mergele të formuara në aspektin gjeologjik që është gjynahi i zotit ma me hy në prodhim të ndoshta të çimento por mund të përdoret si gur ... për veprimtari. Prandaj, gjithçka do të jetë unë e thash gjithçka do të jetë e përpunuar dhe e sqaruar, mirëpo nëse shkohet me mergele të shkrifta të cilat përdoren pa nëse përdoren ... përsëri do të analizohet dhe do të përcaktohet në një çmim i rentës. Por, çdoherë tu e pas, sepse këtu komplikohet edhe më shumë procedura kur hyhet në aspektin profesional me përcaktu deri ku janë kufijtë e shfrytëzimit të një resursi për destinimin në bazë të cilësisë çfarë është. Ta zëmë, a përdoren krejt gurtë, a është logjik që të përdoren krejt gurtë gëlqeror për ... apo duhet një pjesë me shkallë të kristalitetit që edhe Sala meqenëse është gjeologe e din më mirë, duhet të... destinimin t'ia ruajmë me çdo çmim që ajo të shkon si gur dekorues. Prandaj, këtu është ai kompleksiteti që po them edhe njëherë na kemi me bo përpjekje profesionale me iu dhënë informata të bollshme edhe këtë që e ngriti deputeti që ka drejtë, kjo duhet me reflektuar edhe pse është fiks duhet me reflektu sa është në përqindje.

HASHIM DESHISHKU : Faleminderit, kryetar!

Disa sene u thanë që pata edhe me i thënë, por unë pak kesh kur morën fjalën Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Financave dhe Komisioni i Pavarur i vërejtja që thanë që rentat janë caktuar në bazë rajonit, sa unë e kuptova ndoshta e kom pas naj gabim atë e kuptova, kurse nga përfaqësuesi i Ferronikelit thotë që në rajon janë si: në Maqedoni është 1.5, në Greqi 1%, dhe kurse në Kosovë është deri në 4.5% kur u rrit tash 2010-ës.

Normal unë pajtohem me... se vi vetë nga biznesi dhe gjithmonë jam i interesuar për me përkrah biznesin, por nuk jam i interesuar me përkrah biznesin edhe me shkatërruar pasurinë e një shteti ku aty jetohet. Kështu që këto tash sipas fjalimit të përfaqësuesve të Ferronikelit e pash edhe zoti Ahmet e murr fjalën dhe tha që nuk janë disa të vërteta të cilat i thotë përfaqësuesi nga Ferronikeli dhe për këtë unë e kisha kërkuar që me të vërtetë të janë informatat e sakta, si nga ministria apo nga komisioni i pavarur apo nga përfaqësuesit e Ferronikelit apo ... që e kemi këtu Trepçën, por ne... unë prapë them që duhet caktohen rentat në kuadër të rajonit. Duke me të vërtetë, duke me i stimuluar investitorët tu ardh në Kosovë, për arsye se aty e kemi edhe punësimin kemi edhe disa tjera sene që nuk është vetëm shfrytëzimi i pasurisë, por kem edhe të hyra tjera që vijnë nga: punësimi, nga sigurimi, të ardhurat tjera, por prapë them që këto duhet të harmonizohen dhe mos shkojnë deri aty që ne tash ta përkrahim një investitor që është i jashtëm aty edhe ta shkatërrojmë pasurinë tonë, të cilën e kemi edhe të mos kem të hyra, por të normalizohen në rajon.

Përafërsisht të jenë me ... që mos t'i japim mundësinë ne Ferronikelit që të shkon të blen lëndën e parë, unë nuk do të ... si lëndë të parë se nuk i kuptoj ato ... i kuptoj, por nuk e di qysh fillohen. Mos të lejojmë me shku me ble në Maqedoni apo në Greqi apo edhe unë qysh kom një informatë kanë ble thëngjill nga Malajzia, nëse është ajo e vërtetë këto janë në bazë të gazetave, mos t'i lejojmë të blihen diku tjetër nëse kemi na lëndën e parë në vend. Kjo ishte për mu, pajtona me Shoqatën e Zhavorrit që tha që të jetë të zbritet 50%, ajo e propozoi 50%, por ky 50-tshi të analizohet mirë, për arsye se duhet të bëhet kultivimi i pjesëve ku e nxjerrin zhavorrin. Ne e dimë lumenjtë tonë qysh ka shkue, qysh janë ... domethënë, i kemi lumenjtë besoj më të dobët në rajon, të cilët i kemi shkatërruar vetë.

Dhe kjo të bëhet një analizë dhe të kthehet dhe të kontrollohen më shumë, por nëse edhe shteti humb aty një pjesë të mjeteve që nuk janë në rentën nga nxjerrësit e zhavorrit, atëherë le t'i

mundësohet bile edhe një pjesë le të arrihet që me kultivu apo me i mbulu ato farë lumenj, me i rregullu lumenjtë të cilët me i pru në gjendjen e mëparshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! *(Nuk dëgjohet për transkriptim)*... ..

JANNIS MOUTAJIS (Ferronikeli): Okej, kisha dashur vetëm me sqaru që Ferronikeli nuk është ndonjë kompani e cila e nxjerr xehen nga miniera dhe e eksporton ose e shet jashtë... në Shqipëri, në Turqi dhe në Filipinë dhe në disa vendet tjera. Ferronikeli ka bërë një investim mjaftë të madh në Kosovë më shumë se 60.000.000 euro. Është interesuar që të operojë, të vazhdojë për shumë vite në mënyrë që edhe këto investime që i ka bërë t'i kthej mbrapa. Ne e nxjerrim xehen, por kësaj i shtojmë limit përdorim mazut, përdorim një sasi të madhe të rrymës, përdorim edhe oksigjen likuid, në mënyrë që nga xeha të prodhojmë aloi-lëgure, më fal se unë...

Në fund e kemi një prodhim që ka më shumë vlerë që i kemi shtu nga materiali tjetër se sa materiali bazë dhe natyrisht kjo është një prej arsyeve pse ne kemi 20% diskount, në mënyrë që të jemi konkurrentë ... me kompanitë tjera, të cilat vetëm e marrin xehen edhe e shesin jashtë. ... që na e marrim xehet e importuara jo vetëm sa i përket rentës... ka më shumë nikel, por në fund të fundit është interesi ekonomik. Sigurisht që ka të bëjë që xeha e importuar është më e favorshme për neve, mirëpo ka edhe disa nivele të çmimit të nikelit nëpër berza që e bënë xehen vendore më benefiteuese për neve. Për fat të keq tani, por për momentin për neve është më profitabile me importu xehet, sidomos sipas situatës që gjendemi tani. Edhe po du me shfrytëzu rastin ... edhe çështjen e linitit, na kishim dëshiruar me përdor linjitin prej Kosovës, por për arsye të ndryshme ne nuk jemi duke përdorur linjitin nga Kosova që nga tetori i vitit të kaluar dhe jemi detyruar me importu linjit nga Lindja e Largët, por dhe nga Maqedonia. Kemi mjaftë pengesa edhe pse po duam me i përdorë më shumë resurset vendore që i kemi shumë afër, për të cilat nuk kemi transport shpenzime. Për fat të keq ka shumë pengesa që po dalin, nuk po them që renta minerare është problemi më i madh që ne e kemi, por është një prej pengesave që na bënë më të hezitueshëm me përdorë më shumë, domethënë mos me përdorë shumë xehe vendore. Njëjtë ka ndodh edhe me linjit. Ju faleminderit!

(Ndërhyrje)

Ka më shumë ndoshta ... të tjerë që munden me fol për këtë çështje, por sa e di unë ka të bëjë deri në tetor na kanë furnizuar me rreth 5-6.000 ton në muaj. Gjithmonë kemi kërkuar më shumë, por s'kemi mund... dhe na jemi detyruar me importu çdo muaj nga 3-4.000 ton. Nuk e di se çka është arsyeja e vërtetë, por është një çështje midis "Kosova Thëngjillit" dhe KEK-ut me sa e di, por në fund të fundit prapëseprapë ne duhet të detyrohemi me importu thëngjill nga jashtë. Kisha qenë njëri nga njerëzit, menaxherët më të lumtur në Kosovë nëse kisha mund të marr nga 10.000 ton në muaj linjit prej Kosovës.

ADIL JANUZI (KEK): Shiqo, ne e kemi shumë resurse ose shumë sektorë KEK-u i ka larguar qysh më herët, në vitin 2004 jashtë KEK-ut, e një prej tyre është edhe "Kosova Thëngjilli". E vetmja në Kosovë e cila e ka licencën për me shit thëngjill jashtë është "Kosova Thëngjill". Prandaj, kur "Kosova Thëngjilli" u hi në obligime të mëdha ndaj KEK-ut e cila ka hy diku në obligime 4.000.000 ka borxhin në KEK edhe KEK-u është detyruar me ia ndërpre furnizimin me qymyr dhe ne e kemi ndërpre furnizimin me qymyr qysh muajin tetor të vitit të kaluar edhe për ata "Kosova Thëngjilli" ma nuk mundet me i shit kompanisë në fjalë, ose askujt tjetër... për arsye se ne i kemi thënë: "duhet me i pagu paraprakisht gjysmën e borxheve, për me ta liru prapë furnizimin me qymyr". Arsyeja është shumë e thjeshtë, "Kosova Thëngjilli" është e vetmja në vend...

TEUTA SAHATQIJA : .. me ekzistitu ajo arsye, ajo është arsye totalisht pa arsye. Mos me mujt me shit thëngjillin që e kemi aty, mos me mujt me u furnizu nuk mendoj që është arsye.

ADIL JANUZI (KEK): Ajo nuk varet prej neve, domethënë “Kosova Thëngjilli”...

TEUTA SAHATQIJA: Po, duhet me u gjetë zgjidhje...

KRYETARI: Domethënë, sipas tani nuk i bën...

ADIL JANUZI (KEK): Zoti kryetar, e vetmja institucion i cili është legjitim për shitjen i licencum e thëngjillit është “Kosova Thëngjilli”.

KRYETARI: Po, po! Që tash nuk operon për shkaqe që i the ti.

ADIL JANUZI (KEK): Po thash se “Kosova Thëngjilli” ka një shumë të madhe të borxheve ndaj KEK-ut e cila nuk i ka eliminuar ato, nuk është në gjendje me i pagu ato borxhe edhe KEK-u nuk ka pas rrugë tjetër përpos se me i ndal furnizimet me qymyr, sepse borxhi është rrit permanent, është rrit në mënyrë kontinuale rregullisht.

KRYETARI: Mirë! A ka dikush prej deputetëve, nëse ka dikush...nëse po e pastaj...? okej! Më shpejt të lutna!

TEUTA SAHATQIJA: Menaxhim... menaxhim i dobët.

(Ndërhyrje)

.....e xehes që e importon prej jashti çka përfiton shteti i Kosovës nga... S’është më ky interesi i tij, na duhet me i mbrojt interesin e Kosovës.

KRYETARI: Ju kisha lut me pas... sot jemi vetëm për punën e rentës, nuk kemi me i trajtu shumë tema tjera. Nëse e ka dikush ... nëse.... Zonja deputete Shala, Sala Berisha Shala!

SALA BERISHA SHALA: Falemnderit, kryetar! Përsëendetje për të gjithë ërfaqësuesit e institucioneve, që janë këtu!

Një pyetje që e bëri edhe zoti Zharku, cilat janë dallimet që kanë qenë në fuqi deri tash për rentat minerare, unë e kuptova në një kontekst tjetër, a ka ndonjë mineral që më herët ka pas rentën më të rritur e tash është ... dhe anasjelltas.

Unë po e shoh këtu te materialet e palidhura, te inertet, faktikisht te rëra dhe zhavorri, nëse s’gabo, a ka qenë më herët është pagu për m³ 2,50 euro, dhe tash po e shoh 1,25 cent, nëse është ai dallimi. Edhe po shihet që janë dy kategori të rentave, kategori që paguhen me përqindje dhe kategoritë fikse. Dhe, në sqarime e kuptuam që kategoritë me përqindje, varësisht nëse e kam gabim, a është fjala për sa herë të rritet çmimi në berzë, të shkojë një paralelizëm edhe me përqindje apo është ndonjë kalkulim tjetër?

Dhe, tek rërat dhe zhavorret unë mendoj që është pak, sepse ne e dimë katastrofën ambientale dhe degradimin që iu bëhet lumenjve dhe hapësirave rreth lumenjve dhe nuk po ka mundësi që të ndalen operimet ilegale, madje as operimet tjera dhe kjo duhet të jetë një çmim më invest. Vetëm në këtë mënyrë, ndoshta do të arrijmë me e bë një rehabilitim apo me e bë diçka të mirë në lidhje me ambientin.

Tjetër, ka qenë më duket një plan i KPMM, plani për guroret e Kosovës. Dhe, plani për me i ndalu këto, sigurisht që me këto forma e me këto politika mund të vijmë deri tek ai stopim. Tjetër, nuk e pata shumë të qartë përgjigjen nga zoti Tmava, rreth mineraleve metalore, që është fjala, analogji në mes “Feronikelit”, që nxjerr produktin final dhe “Trepçës”, që e ka një gjysmëprodukt. E dua një sqarim më në detaje. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit shumë! Edhe zonja Selmani, pastaj ju!

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetari! Përshëndetje për të gjithë! Kërkoj falje, se unë u inkuadrova me vonesë, për arsye të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit! Ne e kemi këtë listën, këtë vendim, që na i keni pru me listën për renta minerare. Dua t’i drejtohem përfaqësuesit nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Financave dhe Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve, për çështjen e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re”.

Çështja e rentës minerare në këtë rast, për arsye se prodhimi, i cili do të ndërtohet, çështja e termocentralit “Kosova e Re” dhe prodhimi i energjisë, i cili shkon për konsumatorët vendorë, do të keni dallim te renta minerare dhe për prodhimin e energjisë, e cila i dedikohet shitjes?

Këtu do të jetë problemi, për arsye se renta minerare ndikon definitivisht, në ngritjen e çmimit të energjisë elektrike. Kjo kishte me qenë pyetja ime, diçka tjetër jo. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit shumë, zonja Selmani!

AHMET TMAVA (KPMM): Me ju thënë të drejtën e kemi me një implikim shumëdimensional në aspektin profesional. Hapi i parë teknologjik në procesin e eksploatimit të “Feronikelit” është menjëherë hyn në furra në aspektin e përpunimit për me dalë metal. Një hap i tillë teknologjik në “Trepçë” është flotacioni. Për mua është njëjtë, domethënë, ne duhet me e stimuluar që koncentratin me u shndërru në metal. Po, unë mendoj që është analogji që qat projektligj me e marr edhe “Trepça”. Për mua, po ndoshta unë jam laik... unë po e quaj hap sepse nuk po di ku me e dallu, se si fazë e procesit të përpunimit. Mirëpo, unë deshta me u bë transparent, që gjithçka do ta qesim në tavolinë, do ta japim si informacion, që në bazë të sugjerimeve tuaja, pastaj që kjo të shkojë në Parlament, po pasi që të merren krejt sugjerimet.

Unë po e quaj si hap teknologjik. Xehja merret prej natyre, hyn në hapin e parë, “Feronikeli” po e shndërron në shkretore kurse trepça po e shndërron në koncentrat. E tash, këtë nuk e kam të qartë, por po dua me e diskutu, nëse më përkrahin edhe profesionalistët tjerë. Unë po mendoj që kjo është një analogji, që duhet të respektohet. Nëse “Feronikeli” po zbritet nga 20% me këtë stimulim, atëherë ky 20%-shi duhet me shku edhe në “Trepçë”. Kjo është kjo. Kurse, sa i përket Myzejenës, s’ka nevojë për përgjigje se përgjigjen e din! Kjo e përmendi një term lidhur me parandalimin e eksploatuesve, e përdorë këtë kriterin e rritjes së çmimeve, që mendoj se është shumë gabim, se ato s’mund të ndalen në atë formë, veç nëse përdoret ai kriter, veç i detyron hala me ba evazion fiskal ose me iu shmangë atyre tatimeve që tatimohen rreth, gjoja minerale dhe administratës tatimore.

FATMIR ASLLANI (Shoqata “Zhavori”): Po, nuk do të ishte aq kriter i mirë me ngritë vlerën për m³ e me thënë tash ndoshta nuk kanë mundësi me i pagu, e in dalim. Ajo veç i detyron me vjedhë, po bëhem bukval, me vjedhë më shumë edhe mos me e deklaruar.

HALIL QELA (Trepça): Kryetar, a bënë veç... Unë deshta veç me e bë një sqarim, për shembull, ku jemi ne të diskriminuem se për temën e metaleve, në krahasim, për shembull, me “Feronikelin”, i cili shpenzimet për një tonë xehe i ka shumë më të lira se sa në “Trepçë”. Në “Trepçë”, për shembull një ton xehe me e nxjerrë prej 1.000 metrave thellësi, duhet me e dallu.

Këto na llogariten sikur janë në të njëjtën pozitë. Sikur janë në të njëjtin nivel. Ndërsa, shpenzimet tona për me e nxjerrë një ton xehe, dallojnë shumë, në krahasim me “Feronikelin” dhe me të tjerët. Edhe këtë, mendoj se është një element që duhet pasur parasysh. Se, ndryshe është pa minim pa... se ka në sipërfaqe edhe...

JONUZ BULICA (SHARRCEM) A ka mundësi veç edhe një pyetje? E kisha pyet Komisionin e Financave, me siguri se e kanë caktuar çmimin e rentës, a Ministrinë e Financave, pse nuk merret, për shembull, si bazë në rastin konkret, njerëzit, kompanitë që shfrytëzojnë materialin prej pronave të shtetit edhe kompanitë që shfrytëzojnë materialin, për shembull prej pronave private, që i blejnë? Unë mendoj se këtu duhet me qenë një dallim edhe kurrë nuk është bërë një lloj krahasimi. Kështu që, në rastin konkret, ne si “Sharrcem” ose ta zëmë edhe këtu si “Trepça”, “Feronikeli”, ne njëherë po duhet me i ble tokat private me çmim, që sot nuk kanë çmim të caktuar. Edhe për shembull, dikush që e shfrytëzon pasurinë shtetërore, po të ju caktohet një rentë prej pylltarisë. Këtu është një dallim, që besoj se duhet të merret në konsideratë nga Ministria e Financave apo kush i cakton këto renta.

KRYETARI- Ju falemnderit shumë!

Nëse ka edhe dikush prej Ministrisë, ndonjë përgjigje! Nuk është debati i fundit, ju kisha inkurajuar. Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje, përfaqësues të Ministrive, zoti Tmava, përfaqësues të kompanive!

Ka qenë kjo shumë me interes për ne sot, ky dëgjim. Ju kisha inkurajuar që ju në ndërkohë me e shfrytëzu këtë mundësi të kësaj periudhe, që ju edhe njëherë me shkrim me na i dërgu të gjitha ato propozime e shqetësime, që ju i keni, në mënyrë që ne me na e mundësu që na me i trajtu ende në komision disa çështje. Dhe, po ashtu me i mundësu që edhe institucionet përgjegjëse pra, në këtë rast Qeveria eventualisht me e rishiku ndonjë pozicion të ndonjë pjese, ku mendohet me u rishiku lartësia e rentës minerare.

Mendoj që këtë duheni me e bo shpejt. Ju kisha kërku juve përfaqësuesve të kompanive, mundësisht edhe kompanitë tjera, që janë të interesuara, që merren ose do të merren me këtë biznes me inkuraju që edhe ata me e trajtu një shqetësim, derisa kjo listë nuk del në seancën e Kuvendit. Pra, ne do të provojmë ta bëjmë më të mirën të mundshme, që kjo listë të del sa më e pranueshme dhe në përputhje me vizionin e Qeverisë për zhvillimin e këtij sektori. Pra, edhe më në fund Kuvendi besojmë, që do ta bëjë zgjidhjen më të mirë, në përputhje me interesat e vendit tonë, për zhvillimin e këtij sektori. Pra, këtë kohë le ta shfrytëzojmë për edhe një kontribut shtesë të të gjithë juve në këtë drejtim.

Në ndërkohë, unë ju kisha falënderuar!

ADIL JANUZI (KEK): Zonja deputete, të mbeta borxh pak! ... Rreth ... se nuk osht KEK-u aspak fajtor.

TEUTA SAHATQIA: Jo, nuk e pata për KEK-un.

ADIL JANUZI (KEK): Domethënë, ne e vetmja “Kosova-thëngjilli” është që e ka një licencë. Kund në botë s’ka. Dikush ...

TEUTA SAHATQIA: Po, qajo koka gabim!

ADIL JANUZI (KEK): ... me e furnizu dikë e dikush me shitë... domethënë s'kemi qenë në fajtor. Ai ka qenë fajtor, se është shumë... ka shumë obligime ndaj KEK-ut dhe KEK-u s'ka pas alternativë tjetër, pos me e ndërpre furnizimin me qymyr.

TEUTA SAHATQIJA: Unë aty po ju kuptoj plotësisht, po kjo çështje duhet me u zgjidhë. Në qoftë se, ti i ke blerësit edhe i ke një mal me xehe, nuk po mundesh me e shitë, aty duhet me u bë zgjidhjen. Aty duhet me u bë zgjidhje! Se mallin e ke, ai po lyp me e ble, ti po thu jo s'po du me ta shitë! Mendoje fotografinë e malit, ky duhet me dalë me ble jashtë, e qaty ndër kojshi e ka një mal me xehe. Ky është ... i keq.

KRYETARI- Mendoj që ishte një debat i mirë, informata të mira. Mendoj që edhe me shkrim këta do të jenë të interesuar tash të na i sjellin, në mënyrë që të na i hapin rrugën ne edhe në komision me debat, pastaj do të vendosim në përputhje me qato informata, a do të kemi nevojë edhe njëherë në komision me e ftu, qoftë ministrin e Zhvillimit Ekonomik, gjithsesi KPMM-në gjithsesi, domethënë mbas këtyre me vendosë me e përcjellë listën, nëse eventualisht ky debat nxitë ndoshta, ndonjë rishikim të mundshëm për këto, mirëpo pa paragjyku tash në këtë fazë. Po mendoj, debati ishte konstruktiv dhe prej të gjitha palëve. Unë ju falënderoj, po kisha kalu në pikën të ndryshme.

E përgatiti:

Njësia për transkriptim e Kuvendit të Kosovës